




REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

NËNSHKRUHET KONVENTA PËR TRAKTATIN TATIMOR



Shqipëria nënshkroi Konventën Multilaterale për Zbatimin e Masave të Traktatit Tatimor për të Parandaluar Erozionin Bazë dhe Zhvendosjen e Fitimit (Konventa), duke u bërë vendi i 88 që u bashkua me të, e cila mbulon pothuajse 1,530 traktate dypalëshe tatimore. Konventa është traktati i parë shumëpalësh i këtij lloji, duke lejuar vendet të integrojnë rezultatet nga Projekti BEPS OECD / G20 në rrjetet e tyre ekzistuese të traktateve dypalëshe tatimore. Në bazë të saj, vendet anëtare marrin angazhimin për të përket plotësisht të 4 standardeve minimale të Paketës BEPS, e cila në total përbledh 15 Plane Veprimi. Kjo Paketë i pajis shtetet pjesëmarrëse me instrumente vendase dhe ndërkombëtarë për të adresuar shmangien e taksave, në mënyrë që fitimet të taten aty ku kryhen aktivitetet ekonomike që i gjenerojnë ato dhe aty ku krijohet vlera.

KE VLERËSON EKONOMINË SHQIPTARE



Raport Progresi i Komisionit Europian për Shqipërinë konfirmoi qartë drejtimin e duhur që po ndjek Qeveria në një sërë reformash. Në fjalën e saj në Parlament, Ministria Denaj tha se raporti i KE thekson përmirësimin e treguesve kryesorë makroekonomikë dhe parametrevë fiskalë, ku rritja ekonomike arriti nivelin më të lartë në 10 vitet e fundit, një rritje cilësore me ndikim të drejtpërdrejtë në punësim. Eksportet u rritën bindshëm dhe balancat me jashtë u përmirësuan. Investimet e huaja direkte arritën mbi 1mlrd Euro dhe niveli i borxhit publik për vitin 2018 arriti 67.2% i PBB. Së bashku me reduktimin e kredive të këqija në nivelin e 11 %, bëjnë që Shqipëria të ngushtojë hendekun e saj ekonomik me vendet e BE. Gjithashtu, Shqipëria arriti shkallën më të lartë të punësimit në rajon me 52.1 për qind duke shënuar rritjen më të madhe me 1.8 pikë përqindje në vitin 2018.

RIMBURSIMI I TVSH-SË



Stimuli i Investimeve dhe Siguria juridike e Pronës ishte tema e diskutimit në mbledhjen e radhës të Këshillit të Investimeve. Respektimi i të drejtave të pronësisë dhe regjistrimi i plotë dhe përfundimtar i pronës mbetet sfida e qeverisjes. Ministria Anila Denaj theksoi se një qasje koherente, jo e fragmentuar ndaj problemeve të pronësisë, konsiderohet thelbësore për ekonominë e një vendi dhe përbën parakusht për stimulimin e investimeve. "Çdo progres në këtë fushë rrit sigurinë ligjore për investitorët, nxit transparencën në mirëqeverisjen dhe luftën ndaj korrupsionit, si dhe reflektohet menjëherë në raportet ndërkombëtare mbi reformat në Shqipëri", u shpreh Ministria. Ligji i ri i unifikimit të investimeve që MFE ka publikuar për konsultim publik synon të përmirësojë kushtet dhe ofrojë balancimin e tyre, si për investitorët e huaj, ashtu edhe për investitorët e vendas.

KËSHILLI I INVESTIMEVE



MFE ka përgatitur për herë të parë një Raport Zyrtar për Financat Vendore, i cili u prezantua në një konferencë kombëtare me përfaqësues të pushtetit lokal në vend. Raporti vëren se menaxhimi i financave publike në nivel vendor është përmirësuar ndjeshëm. Madhësia e transferit të pakushtëzuar, si një ndër burimet kryesore të financimit të buxhetit të shtetit për qeverisjen vendore, është 42% më e lartë se sa ajo e vitit 2015. Tendenca në rritje ka vazhduar edhe në vitin 2019 ku rritja është mbi 1 miliard lekë. Për vitin 2018, krahasuar me 2017, të ardhurat totale të pushtetit vendor ishin rreth 6 miliard lekë më të larta. MFE shprehu gatishmërinë e saj për reformimin e financave publike, qendrore dhe vendore, me qëllim që paratë e taksapaguesve të përdoren për të përmirësuar jetën dhe mirëqënien e qytetarëve.

QYTETE MIQËSORE PËR FËMIJËT



Ministria e Financave dhe Ekonomisë është angazhuar në një dialog të vazhdueshëm me pushtetin vendor për të siguruar planifikim buxhetor, për të vendosur objektiva dhe për të matur rezultate, të cilat vlerësohen në fund me nivelin e zhvillimit ekonomik. Në konferencën ndërkombëtare "Për qytetet miqësore për fëmijët", organizuar nga UNICEF dhe bashkia Tiranë, Ministria Denaj apeloj për rritje të qëndrueshme të investimeve të Bashkive nga niveli mesatar prej 29 % sot, ndërsa tha se bizneset mund të bëjnë shumë më tepër për të krijuar hapësira miqësore për gjeneratën e re. Me mbështetjen dhe lehtësimin e MFE, bashkëpunimi i trinomit qeveri vendore-biznes-komunitet, do të jetë edhe më proaktiv ndaj fondeve për të krijuar qytete me miqësore për fëmijët.

PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS



3251 persona kanë mundur të punësohen nëpërmjet ndërmjetësimit të zyrave të punës në të gjithë vendin gjatë muajit Maj 2019.

Ndërkohë, cikli i Panireve Rajonale të Punësimit vijoi me Panairin në Berat.

35 kompani nga Berat, Kuçova dhe Skrapari prezantuan në panair 218 vende të lira pune, në sektorë si: hotelieri-turizëm, industri përpunuese, ndërtim, shërbime transporti, tregtare, apo telekomunikacioni. Pjesëmarrës në ishin dhe ofrues të arsimit dhe formimit profesional që ushtrojnë aktivitetin në Rajonin e Beratit, përfaqësues të institucioneve vendore, si dhe përfaqësues të projekteve bashkëpunuese në fushën e Arsimit, Formimit Profesional dhe Punësimit.